



Prishtinë: 19.12.2008.

Kodi i ZRRE-së: V_148_2008

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_R_153_12_08

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK_R_153_12_08; dhe
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Në mbledhjen e mbajtur më 19 dhjetor 2008 nxori këtë:

VENDIM

PRANOHET ankesa e konsumatorit Baton Zhubi (shifra e konsumatorit DPR - 90023664) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK të ZRRE-së të 02.09.2008 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 21.08.2008, lidhur me kontestimin e faturave të energjisë elektrike të muajit 07/2006, 09/2006, 10/2006, 04/2007, 09/2007, 12/2007.

- Me datë 05.09.2005, KEK-u ka dalë tek konsumatori dhe ka bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku ka hequr njehsorin e vjetër 17719535 dhe ka vendosur njehsorin e ri digjital nr. 200492.
Provë: Vërtetimi mbi ndërrimin e njehsorit elektrik të datës 05.09.2005
- Në muajin 07/2006 konsumatori nga ana e KEK-ut i ka arritur fatura e energjisë elektrike në vlerë financiare prej 982.98 €.
Provë: Transaksionet e konsumatorit.
- Në muajin 09/2006 konsumatori nga ana e KEK-ut i ka arritur fatura e energjisë elektrike në vlerë financiare prej 584.14 €.
Provë: Transaksionet e konsumatorit.
- Në muajin 10/2006 konsumatori nga ana e KEK-ut i ka arritur fatura e energjisë elektrike në vlerë financiare prej 382.55 €.
Provë: Transaksionet e konsumatorit.
- Në muajin 04/2007 konsumatori nga ana e KEK-ut i ka arritur fatura e energjisë elektrike në vlerë financiare prej 168.90 €.
Provë: Transaksionet e konsumatorit.



- Në muajin 09/2007 konsumatorit nga ana e KEK-ut i ka arritur fatura e energjisë elektrike në vlerë financiare prej 1506.44 €.
Provë: Transaksionet e konsumatorit
- Në muajin 12/2007 konsumatorit nga ana e KEK-ut i ka arritur fatura e energjisë elektrike në vlerë financiare prej 486.64 €.
Provë: Transaksionet e konsumatorit
- Me datë 04.01.2008, KEK-u ka dalë tek konsumatori dhe ka bërë ndërrimin e njehsorit elektrik ku ka hequr njehsorin elektrik digjital nr. 200492 dhe ka vendosur njehsorin elektrik nr. 12457934.
Provë: Vërtetimi mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 2040 të datës 04.01.2008
- Me datë 11.02.2008, qendra e kalibrimit në KEK ka bërë shqyrtimin detal të njehsorit elektrik dhe ka konstatuar se njehsori elektrik është brenda kufijve të lejuar të matjes së energjisë.
Provë: Protokoli mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik nr. 1003 të datës 11.02.2008
- Me datë 07.06.2008, konsumatori ka parashtruar ankesë në departamentin për konsumatorë në KEK duke dyshuar në saktësinë e njehsorit elektrik dhe duke kundërshtuar faturat e energjisë elektrike 07/2006, 09/2006, 10/2006, 04/2007, 09/2007, 12/2007.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK.
- Me datë 09.09.2008, departamenti për konsumatorë në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në procesin e kalibrimit të KEK-ut.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 21.08.2008.
- Me datë 10.09.2008 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së.

DMK në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEK-ut, ka vërejtur se:

- ✓ Konsumatori kur ka vërejtur se faturat e energjisë elektrike i kanë arritur me vlera të larta ka kërkuar që njehsori elektrik i konsumatorit të dërgohet në kalibrim për tu matur saktësia e njehsorit.
- ✓ Konsumatori disa muaj është faturuar nga ana e KEK-ut me konsum mujor me vlera të larta, ku shihet se ka disproporcion të konsumit.
- ✓ Mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike me njehsorin nr. 10689826 (prej 08/2002 – 04/2004) është 259.7 kWh.
Provë: Rrjedhja e energjisë aktive.
- ✓ Mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike me njehsorin nr. 17719535 (prej 05/2004 – 09/2005) është 188.3 kWh.
Provë: Rrjedhja e energjisë aktive.
- ✓ Mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike me njehsorin digjital nr. 200492 (prej 09/2005 – 01/2008) është 2678 kWh.
Provë: Rrjedhja e energjisë aktive.



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

- ✓ Mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike me njëhisorin nr. 12457934 (prej 02/2008 – 09/2008) është 224 kWh.
Provë: Rrjedhja e energjisë aktive.
- ✓ Vlerat ekstreme të regjistrimit janë vërejtur për këta muaj: 11.2005 (**5,247** kWh); 07.2006 (**16,156** kWh); 09.2006 (**8,056** kWh); 10.2006 (**4,325**); 09.2007 (**17,609** kWh); 12.2007 (**3,945** kWh)
- ✓ Konsumatori ka biznes të berberit, andaj realisht nuk mund të ketë shpenzim të madh të energjisë elektrike.

DMK në ZRRE pas analizimit të dëshmive të paraqitura i rekomandon Bordit të ZRRE-së që të **pranojë** ankesën e konsumatorit.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që ta **pranojë** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së,

Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

1. Ta shkarkojë konsumatorin prej faturave 11.2005, 07/2006, 09/2006, 10/2006, 09/2007, dhe 12/2007 të ngarkuar nga ana e KEK-ut;
2. Ta ngarkojë konsumatorin për muajin 07/2006, 09/2006, 04/2007, 09/2007 me një mesatare të muajve të verës dhe për muajt 10/2006, 12/2007 me një mesatare të muajve të dimrit, pasi që konsumatori në këta muaj ka bërë shpenzim dhe për këto muaj ai duhet të ngarkohet me këto mesatare.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente të Prishtinës, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Dr. Nysret Avdiu, anëtar